

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË AKSIONERE
“TREGU - MAT” SH.A**

Sot, më datë 26.04.2022 (dymijë e njëzet e dy), Aksioneri themelues;

- **Bashkia MAT**, person juridik publik, organizuar dhe ekzistues sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë me adresë të rregjistruar, Sheshi “Kastriotët” Nr.1, KP 8001, Burrel,

vendosi themelimin e shoqërisë “**TREGU - MAT**” Sh. A., përmes këtij Akti - Themelimi.

NENI 1

- 1.1 Shoqëria Tregtare “**TREGU - MAT**” Sh. A., themelohet në formën e një Shoqërie Aksionere, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, të ndryshuar (këtu më poshtë Shoqëria).
- 1.2 Shoqëria është një entitet ligjor shqiptar dhe ka formën ligjore të një shoqërie aksionere (“shoqëri aksionere” ose Sh.A.)

NENI 2

Emri dhe vula e shoqërisë

- 2.1 Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “**TREGU - MAT**” Sh.A.
- 2.2 Shoqëria do të ketë vulën e saj.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

- 3.1 Objekti i shoqërisë përfshin, por pa u kufizuar, aktivitetet e mëposhtme:
 - a) Projektim, ndërtim, rindërtim, zbatim, të tregjeve me qëllim tregtimin e produkteve bujqësore, dhe/ ose tregjeve të kafshëve të gjalla publik, si dhe ndërtime të tjera me karakter tregtar.
 - b) Funkcionimi i tregut me shumicë e pakicë të produkteve bujqësore dhe/ ose të kafshëve të gjalla.
 - c) Dhënia me qira e hapësirave dhe ambjenteve të tregut me shumicë e pakicë, personave fizik dhe juridik që tregtojnë produkte bujqësore dhe kafshë të gjalla.
 - d) Dhënia me qira e hapësirave dhe ambjenteve personave fizik dhe juridik që sigurojnë shërbime të ndryshme për përdoruesit e tregut me shumicë, me qëllim që aktiviteti i tyre tregtar të jetë sa me eficient.
 - e) Nxitja e shitjes së prodhimeve lokale të produkteve bujqësore, dhe kafshëve të gjalla, duke organizuar aktivitetet përkatëse si panairë, ekspozita, si dhe promovimi i prodhimeve lokale gjatë gjithë vitit.



- f) Kryerja e investimeve duke mobilizuar kapital shtetëror dhe /ose privat vendas apo të huaj.
- g) Shoqëria siguron transparencë për transaksionet tregtare që zhvillohen brenda tregut me shumicë e pakicë. Ajo grumbullon dhe shpërndan të dhëna për tregun tek të gjitha palët e interesuara.
- h) Shoqëria bashkëpunon ngushtë me të gjithë inspektorët përkatës dhe autoritetet ekzekutive publike për të siguruar që:
 - transaksionet që zhvillohen në tregun me shumicë e pakicë të bëhen në përputhje me ligjin;
 - përdoruesit e tregut të kenë licensën përkatëse në rastet që kërkon ligji.
- i) Aplikimin për përfitimin e fondeve publike dhe private në kuadër të zhvillimit të tregjeve;
- j) Këshillimi dhe planifikimi në sektorin e shërbimeve publike dhe/ose private;
- k) Realizimin, krijimin, zhvillimin, menaxhimin dhe shitjen e projekteve, pasurive, mallrave dhe shërbimeve, për arritjen e qëllimeve dhe objektivave tregtare në përputhje me këtë statut dhe me aktet ligjore në fuqi;
- l) Blerje, shitje, administrim, të materialeve dhe të çdo lloj pasurie të luajtshme dhe /ose të paluajtshme, në zbatim e në përputhje me aktivitetin e shoqërisë;

3.2 Për qëllimin e realizimit të objektit të saj Shoqëria mund;

- a) Të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm që lidhet me pasuri të luajtshme dhe/ose të paluajtshme si dhe të ushtrojë të gjithë të drejtat reale të pronarit mbi to duke përfshirë por pa kufizuar në zhvillimin, dhënien me qira, enfiteozë, leasing, përdorimin, transferimin, shitjen, përodrimin si hipotekë, peng, garanci ose të përdorimit në forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, duke u bazuar në parimet e ruajtjes dhe garantimit të interesit publik, rritjes së vlers ekonomike të pronës, kthimin e arsyeshëm të investimit, në vlerën më të mirë të parasë (fitimet maksimale të mundshme) si dhe leverdisshmërisë publike;
- b) Në funksion të ushtrimit të veprimtarsisë së saj, Shoqëria me iniciativë të saj dhe ose me prorpozim të institucioneve, eneteve publike, personave fizike apo juridikë privatë, vendas apo të huaj, identifikon zona dhe/ose pasuri si investitorë dhe/ose zhvilluese, vetë ose në bashkëpunim me sektori publik dhe /ose privat sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Shoqëria sipas rastit, vendos të jetë investuese dhe/ ose zhvilluese e vetme në projekt investimi ose bashkëzhvilluese dhe/ ose bashkëinvestuese në bashkëpunim me sektorin publik dhe/ose privat, porositëse e investimit, apo bashkëpjesmarrëse në investim në çdo lloj forme tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi;
- c) Me iniciativë të vet dhe/apo propozim të subjektit/eve private Shoqëria mund të vendosë troje në pronësi të saj në dispozicion të zhvilluesit privat me qëllim zhvillimin e tyre. Forma e financimit të investimit të ndërtimit si dhe forma e bashkëpunimit përcaktohet rast pas rasti. Kushtet, kriteret dhe procedura e përzgjedhjes të zhvilluesit privat bëhet në bazë të parimit të konkurrueshmërisë dhe të legjislacionit përkatës që rregullon këtë fushë përveç rasteve kur



sipas analizës ligjore dhe/ ose studimit të fizibilitetit është e pamundur që projekti të ketë leverdisshmëri nëse nuk përshtatet me rrethanat e situatave konkrete, që ndikojnë kontraktimin direkt të një zhvilluesi. Ndërmjet zhvilluesit dhe shoqërisë nënshkruhet marrëveshja përkatëse ku përcaktohen të drjetat dhe detyrimet e palëve.

Pasuritë e përfituara nga zhvillimi/ investimi regjistrohen në emër të shoqërisë dhe ajo gëzon të gjitha tagrat e pronarit sipas legjislacionit në fuqi.

- d) Shoqëria, me qëllimin e vetëm për të realizuar objektin e saj, mund të kryejë të gjitha operacionet në fushën e ndërtimit, industrisë, tregtisë, pasurive të patundshme dhe në fushën financiare që lidhen me objektin e shoqërisë, ose që kanë lidhje me të; mund gjithashtu të kontribuojë, drjetpërsëdrjeti ose tërthorazi, por gjithmonë me qëllimin e vetëm për arritjen e objektit të shoqërisë me pjesmarrje dhe interesa në shoqëri të tjera dhe shoqëri me objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të.
 - e) Të shqyrtojë dhe të vlerësojë mundësinë e bashkëpunimit me shoqëri të tjera tregtare në të gjitha format që parashikon legjislacioni në fuqi.
- 3.3** Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të lëshuara nga organet kompetente të fushës.

NENI 4

Selia e shoqërisë

- 4.1** Selia e shoqërisë është me adresë; *Mat, Burrel, Njësia Administrative Burrel, Rruga "Ibrahim Temo" Lagja "Partizani" Burrel, godina e shoqërisë "UKM" Sh.A.*
- 4.2** Këshilli i Administrimit mund të hapë apo mbyllë degë dhe/ ose zyrë përfaqësimi ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë

- 5.1** Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë është në vlerën: **30 211 950** (*tridhjetë milion e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë*) **lekë**, i cili përbëhet nga 1000 aksione të zakonshme me një vlerë nominale prej **30 211.95** (*tridhjetë mijë e dyqind e njëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e pesë*) **lekë** secili, që përfaqësojnë kontribute në natyrë të aksionerit Bashkia Mat. Kapitali është nënshkruar, si më poshtë:
- Bashkia Mat zotëron 100 % të vlerës së kapitalit të Shoqërisë të barabartë me 1000 aksione me vlerë të përgjithshme prej **30 211 950** (*tridhjetë milion e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë*) **lekë**.



5.2 Asambleja e Përgjithme mund të zmadhojë kapitalin me anë të aksioneve të reja, zmadhimit të kufizuar të kapitalit, zmadhimit të autorizuar të kapitalit, përfshirjes së rezervave të disponueshme dhe fitimeve të pashpërndara në kapitalin ekzistues, emetimit të obligacioneve të konvertueshme në anksione dhe rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese.

5.3 Në rast;

- a) Zmadhimi të kapitalit me anë të emetimit të aksioneve të reja, aksionarët ekzistues të Shoqërisë do të kenë të drejtën e parablerjes mbi aksionet e emetuara rishtazi, në përpjestim me numrin e aksioneve që ata zotërojnë;
- b) Zmadhim të kufizuar të kapitalit, aksionet e reja mund të nënshkruhen vetëm nga aksionarët ekzistues.
- c) Zmadhim të kapitalit me anë të rezervave të disponueshme dhe fitimeve të pashpërndara, aksionarët ekzistues të Shoqërisë do të kenë të drejtën e parablerjes mbi aksionet e emëtuara rishtazi, në përpjestim me numrin e aksioneve që ata zotërojnë;
- d) Zmadhim të kapitalit me anë të emetimit të obligacioneve të konvertueshme në aksione, aksionarët ekzistues të Shoqërisë do të kenë të drejtën e përfitimit mbi këto obligacione në përpjestim me numrin e aksioneve që ata zotërojnë;
- e) Rritje të vlerës nominale të aksioneve ekzistuese, kjo rritje do të paguhet proporcionalisht nga aksionarët ekzistues.

5.4 Asambleja e Përgjithëshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë me anë të zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve, zvogëlimit të thjeshtëzuar të kapitalit ose anulimit të aksioneve, por në asnjë rast kapitali nuk mund të zvogëlohet nën vlerën minimale të parashikuar nga ligji.

NENI 6

Aksionet

6.1 Aksionet janë të zakonshme.

6.2 Akti i emetimit të aksioneve hartohen në çastin e emetimit fillestar të aksioneve dhe përmban informacionin dhe duhet të respektojë procedurat e parashikuara nga ligji në fuqi.

6.3 Çdo aksion jep të drejtën e një vote.

6.4 Shoqëria do të hartojë dhe mbajë një regjistër të aksionarëve të Shoqërisë në selinë e sajë, i cili duhet të përmbajë meqënëse aksionari është person juridik; numrin e aksionarëve, vlerën nominale të aksioneve, adresën ose selinë e aksionarit dhe datën e kryerjes së regjistrimit të aktit.

NENI 7

Kohëzgjatja e shoqërisë

7.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë është e pakushtëzuar.



NENI 8 Organet Drejtuese

8.1 Organet drejtuese të shoqërisë aksionere:

- 1) **Asambleja e Përgjithshme**
- 2) **Këshilli i Administrimit**, përbëhet nga;
 - a) **Ervin HYSA**, Kryetar;
 - b) **Dorian RRUCI**;
 - c) **Armando SKONJA**, në cilësinë edhe të Administratorit/ Drejtorit të Përgjithshëm
- 3) **Eksperti Kontabël i Autorizuar**, i cili do të jetë:
 - **Z. Bujar BENDO** – mbajtës i letërnjoftimit me nr.personal: **G60702148I**, i liçensuar për ushtrimin e profesionit të audituesit ligjor sipas vendimit të Komitetit të Regjistrimit, **Nr.79, datë 12.04.2000**.

8.2 Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë.

NENI 9 Eksperti/ët kontabël i/të autorizuar

- 9.1 Auditimi i brendshëm i Shoqërisë kryhet nga ekspertë kontabël të autorizuar pjesë të strukturave të saj të brendshme, të emëruar për një afat 3 (tre) vjeçar dhe me të drejtë rizgjedhje. Shoqëria në rast nevojë mund të vendosë që të marrë edhe ekspert kontabël të autorizuar të jashtëm. Në këtë rast Administratori i paraqet Këshillit të Administrimit emrat e ekspertëve kontabël të autorizuar të jashtëm si dhe një raport të arsyetuar në lidhje me detyrat dhe objektivat që kërkohen të arrihen prej tyre.
- 9.2 Pas miratimit nga Këshilli i Administrimit emrat e ekspertëve kontabël të autorizuar të jashtëm së bashku me Vendimin e Këshillit të Administrimit i paraqiten për miratim Asamblesë së përgjithshme si organ i cili bën emërimin e tyre.

NENI 10

- 10.1 Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11 Legjislacioni i aplikuar



11.1 Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga Aksionari themelues. Çdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disponohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozitat ligjore në fuqi.

NENI 12

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

12.1 Mosmarrëveshje që mund të lindin gjatë aktivitetit të shoqërisë zgjidhen me konsensus, në të kundërt palët i drejtohen gjykatës kompetente.

NENI 13

Dispozitat Përfundimtare

13.1 Akti i themelimit përpilohet në katër kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

AKSIONARI THEMELUES

BASHKIA MAT

Përfaqësuar nga;

KRYETARI

AGRON MALAJ

